

13 korrik 2015, Prizren

Komunikatë për medie

KOMUNA E PRIZRENIT ME DEFЕКTE NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” ka shqyrtuar efikasitetin e Komunës së Prizrenit në lejimin e qasjes në dokumente publike në përputhje me Ligjin përkatës.

Në kuadër të projekteve të saja, EC Ma Ndryshe përgjatë periudhës janar-qershor 2015 në Komunën e Prizrenit ka deponuar mbi 30 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe informata, me ç’rast ka evidentuar vonesa që shkojnë në më shumë se dy javë në ofrimin e përgjigjes, derisa disa kërkesa ende janë pa përgjigje zyrtare.

Ndër dikasteret më të papërgjegjshme për ofrimin e qasjes në dokumentet publike është treguar Drejtoria e Inspektorateve, e cila ka shpërfillur pesë kërkesa të adresuara për çështje të ndryshme duke mos ofruar asnjë përgjigje. Ndërkohë në raste të caktuara edhe Drejtoria e Urbanizimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk e kanë parë të udhës që të ofrojnë informatat apo sqarimet e kërkuara bazuar në dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Këto të gjetura edhe njëherë tregojnë se përpjekjet e Komunës së Prizrenit për të siguruar qasje në dokumentet publike në përputhje me dispozitat e Ligjit përkatës janë të pamjaftueshme dhe se nevojitet një mobilizim i shtuar për të garantuar këtë të drejtë për kërkuesit e dokumenteve publike.

Po ashtu këto të gjetura janë dëshmi se Komuna e Prizrenit ka hapësirë që të përmirësoj transparencën e saj karshi qytetarëve. Në të njëjtën janë konfirmim i një konstatimi të mëparshëm të EC Ma Ndryshe mbi rrjedhën e ngadaltë të informatave dhe dokumenteve nga të gjitha drejtoritë të Zyra për Informim dhe Komunikim, gjë që sjell deri te mos publikimi i vendimeve në kohë reale dhe mos informimi i duhur i publikut për çështje të ndryshme relevante, por edhe defekte në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Për këtë arsye, EC Ma Ndryshe i bën thirrje edhe njëherë Komunës së Prizrenit që:

- Të zbatoj në përpikëri dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike;
- Të rris transparencën, duke i publikuar të gjitha dokumentet publike në ueb faqen e komunës;
- Të eliminoj vonesat në ofrimin e përgjigjeve lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike; dhe
- Të informoj zyrtarët dhe shërbyesit civil mbi rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Projektin “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” EC Ma Ndryshe ka nisur që ta zbatoj nga maji i vitit 2015, falë përkrahjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, i cili

do të ketë shtrirje në shtatë komunat kryesore të Kosovës, Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë. Për ta përpiluar Indeks të Transparencës Komunale janë dizajnuar 13 grupe indikatorësh të cilët kanë rëndësi të veçantë në vlerësimin e transparencës së komunave dhe vlerësimet për secilën komunë do të bazohen në kritere të njëjta.

Projekti në fjalë ka për qëllim që ti asistoj komunat në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre. Indeksi i Transparencës paraqet edhe një përpjekje të strukturuar për të mbështetur komunat e Kosovës në përmbushjen e standardeve të qeverisjes së mirë, të përcaktuara me reformën e qeverisjes lokale dhe agjendën evropiane të Kosovës.

Me respekt,
Elmedina Baxhaku, monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale" përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.